



REPUBLIKA E SHQIPERISË
MINISTRIA E MJEDISIT
AGJENCIA KOMBËTARE E MJEDISIT
DREJTORIA E SHQYRTIMIT DHE MONITORIMIT TË LEJEVE MJEDISORE DHE VNM

AN100820260087

Tiranë, më 14.08.2026

Komisioni 93

DEKLARATË MJEDISORE

Në mbështetje të Ligjit Nr. 12/2015 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 10440, datë: 07.07.2011, “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, VKM 714, datë: 06.11.2019, për disa ndryshime dhe shtesa në VKM 686, datë: 29.07.2015, “Për miratimin e rregullave, përgjegjesive e afateve, për zhvillimin e procedurës së transferimit të Vendimit e Deklaratës Mjedisore”, të ndryshuar, dhe me propozim të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, Ministri

VENDOSI:

Lëshimin e Deklaratës Mjedisore për **Zhvilluesin** me të dhënat si më poshtë:

Personi Juridik: “ALLKURTI” sh.p.k

Nr. NIPT-i: L01614001R

Adresa e selisë: Tirane PASHKASHESH Ambient i hapur ne zonen nr 580/1 per prodhim material ndertimi, inerte.

Personi përgjegjës: Bledar Allkurti

Për të zhvilluar projektin: “SHFRYTËZIM DHE PËRPUNIM I MINERALIT GUR GËLQEROR”.

Aplikimi është bërë referuar ligjit Nr. 10 440, date: 7.7.2011 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, Shtojca I, “Projektet që i nënshtrohen Proedurës së Thelluar të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis”, Pika 19. Gurore dhe miniera sipërfaqësore, ku sipërfaqja e vendit është mbi 0,5 hektarë, ose vende për nxjerrjen e torfës, ku sipërfaqja e vendit është mbi 1 hektar.

Vendndodhja: Leja Minerare Nr. 580/3, Dt 13.11.2000, Objekti “Mali I Pashkasheshit”, Bashkia Tiranë, Qarku Tiranë

Të dhëna teknike:

Mbështetur në deklaratimet e AKBN-së.

-Sipërfaqja e lejes minerare të shfrytëzimit, nr.580/3 prot. date 13.11.2000 është 0.1km²

-Sipërfaqja e lejes minerare së bashku me zonën e zgjeruar S=0.4km²

(Bashkangjitur vendimit, gjeni aneksin me hartën topografike dhe koordinatat metrike, ku tregohet vendodhja e objektit)

Bazuar në nenin 12, të ligjit nr. 10440, datë 7.7.2011, “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, i ndryshuar, i sugjerohet autoritetit planifikues:

Miratimi i lejes/licencës së zhvillimit të atij projekti, me kushtet që duhet të përmbushen nga zhvilluesi, për të parandaluar, minimizuar dhe menaxhuar ndikimet negative në mjedis;

Bazuar në pikën 2, të nenit 12, të ligjit nr. 10440, datë 7.7.2011, “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, të ndryshuar, më poshtë po listojmë:

Ky subjekt është pajisur me Njoftim për fillim procedure në komisionin Nr.12, datë 03.02.2025 sipas mendimeve të mëposhtëme.

1. Qëndrimin e Ministrisë dhe sipas rastit, kushtet që duhet të përmbushen nga zhvilluesi:

Drejtoria e Ndryshimeve Klimatike shprehet si më poshtë vijon:

- ☐ Në zbatim të legjislacionit përkatës për fushën e menaxhimit të kimikateve, sugjerohet që gjatë fazës së ndërtimit, të mbahen në konsideratë rekomandimet e mëposhtme:
- Subjekti dhe punonjësit duhet të jenë të familjarizuar dhe të respektojnë në mënyrë rigorozë masat dhe rekomandimet për mbrojtjen, sigurinë e njeriut dhe mjedisit, nga kimikatet që do të përdoren për qëllime të këtij aktiviteti, në zbatim të ligjit nr. 27/2016 “Për menaxhimin e kimikateve”;
- Kimikatet ose produktet/artikujt që i përmbajnë ato, që do të përdoren, të jenë të klasifikuara, etiketuara, paketuara dhe të shoqërohen me dokumentacionin me të dhënat e sigurisë kimike (MSDS), sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi (VKM-së nr. 488, datë 29.6.2016 “Për klasifikimin, etiketimin dhe ambalazhimin e kimikateve”, si dhe VKM-së nr. 9, datë 9.1.2019 “Për rregullat e detajuara dhe metodat për kryerjen e vlerësimit të sigurisë së kimikatit, si edhe kërkesat specifike, përmbajtja dhe formati i dokumentit me të dhënat e sigurisë”);
- Kimikatet ose produktet/artikujt që i përmbajnë ato, që do të përdoren, të ruhen dhe menaxhohen në mënyrë të sigurt, në zbatim të ligjit nr. 27/2016 “Për menaxhimin e kimikateve”.
- ☐ Në zbatim të legjislacionit përkatës për fushën e ndryshimeve klimatike, sugjerohet që të kryhet rehabilitimi i plotë i sipërfaqeve të gjelbra të dëmtuara si rezultat i ushtrimit të aktivitetit.
- ☐ Gjithashtu me qëllim mbrojtjen e mjedisit, përdorimi i lëndëve plasëse, të bëhet në përputhje me Ligjin nr. 74/2021 “Për hedhjen në treg dhe mbikëqyrjen e lëndëve plasëse për përdorim civil”.

Drejtoria e Ekonomisë Qarkulluese shprehet :

Të zbatohet Ligji nr. 57, datë 16.10.2025 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”.

Mbetjet që do të krijohen, të specifikohen sipas kodeve të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 402, datë 30.06.2021 “Për miratimin e katalogut të mbetjeve”.

Të respektohen kërkesat e VKM nr. 418, datë 25.06.2014 “Për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në burim”.

Të zbatohen kërkesat e VKM nr. 575, datë 24.6.2015 “Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte”.

Transferimi i mbetjeve jo të rrezikshme të shoqërohet me plotësimin e shtojcës 1 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 229, datë 23.04.2014, “Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe të dokumentit të transferimit të mbetjeve jo të rrezikshme”, të ndryshuar.

Mbetjet e rrezikshme, të dorëzohen sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 371, datë 11.06.2014 “Për përcaktimin e rregullave për dorëzimin e mbetjeve të rrezikshme dhe miratimin e dokumentit të dorëzimit të mbetjeve të rrezikshme”, të ndryshuar.

Subjekti që do të transportojë ose do të transferojë mbetjet të jetë i pajisur me liçensë III.2.B, si detyrim i nenit 68, të ligjit nr. 57, datë 16.10.2025 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”.

Për të gjitha mbetjet nga ambalazhet të zbatohet Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 177, datë 06.03.2012, “Për ambalazhet dhe mbetjet e tyre”, i ndryshuar.

Në veprimtarinë për të cilën aplikon subjekti, menaxhimi i mbetjeve të bëhet sipas parimit të përgjegjshmërisë ndaj mjedisit, në përputhje me VKM nr. 418, datë 27.5.2020 “Për miratimin e Dokumentit të Politikave Strategjike dhe të Planit Kombëtar për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve, 2020-2035”, duke synuar uljen e sasisë së mbetjeve të gjeneruara dhe menaxhimin e integruar të mbetjeve.

Drejtoria e Biodiversitetit për këtë aktivitet shprehen: Pas plotësimit të dokumentacionit dhe duke qenë se subjekti ka aplikur për heqje nga fondi pyjor, vlerësojmë se:

- për sipërfaqet pyjore, duhet të ketë parasysh parashtrimet ligjore të ligjit 57/2020, datë 30.4.2020 “Për pyjet”, të ndryshuar;
- duhen vazhduar dhe ndjekur procedurat sipas VKM nr.888, datë 27.12.2022, si dhe parashtrimet konkrete për rehabilitimin e këtyre sipërfaqeve;
- të mbajë në konsideratë ligjin nr. 9587, datë 20.7.2006 “Për mbrojtjen e biodiversitetit”, i ndryshuar;
- të realizojë reabilitimin e sipërfaqeve të të gjitha elementeve të projektit.

Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore shprehet:

- Sipërfaqja e lejes minerare të shfrytëzimit, nr.580/3 prot. datë 13.11.2000 është 0.1km²
- Sipërfaqja e lejes minerare së bashku me zonën e zgjeruar S=0.4km²
- Nuk është kryer rehabilitimi i sipërfaqes ekzistuese të shfrytëzuar, pasi aktiviteti mineral i këtij subjekti nuk ka filluar
- Zona minerare e siperpermendur nuk ka qenë leje kerkim-zbulimi.

Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura shprehet se: Bazuar në dokumentacionin e aplikimit, sipërfaqja ku do të zhvillohet aktiviteti: “Shfrytëzim i mineralit të gurit gëlqeror”, Leja minerare nr. 580/3, dt 13.11.2000, Objekti “Mali i Pashkasheshit”, Bashkia Tiranë, me zhvillues “ALLKURT” dhe aplikues “STUDIOPROJEKT”, me nr. Aplikimi AN090220260126, nuk ndodhet brenda rrjetit të zonave të mbrojtura.

Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore shprehet se: Referuar gjurmës së zonës që do të zhvillohet shfrytëzim i mineralit të gurit gëlqeror, që rezulton prej koordinatave të konturit të dhëna në dokumentin

“Raporti Teknik” të paraqitur nga ju, të dhënave për trupat ujorë sipas shtresës Hidrografia dhe shtresën e Hartave Bazë, në Gjeoportalin ASIG, rezulton se brenda kufijve të projektit të zhvillimit ndodhet trupi ujor sipërfaqësor, përkatësisht:

➤ përroi me Inspire Id ASIG_Hid_PrrL_73079

Ministria e Infrastruktures dhe Energjise shprehet se: Shoqëria “Allkurti” sh.p.k., është zotëruese e lejes minerare Nr.580/3, datë 13.11.2000, për shfrytëzimin e mineralit të gurit gëlqeror, objekti “Mali i Pashkasheshit”, Bashkia Tiranë, Qarku Tiranë, dhe me shkresën Nr.7413/3 prot MIE, datë 24.12.2025, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë i ka dhënë të drejtën, për të aplikuar në QKB për zgjerimin e sipërfaqes së lejes minerare të shfrytëzimit.

Për sa më sipër, në zbatim të Ligjit Nr. 10 304 “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, shprehem dakord për vazhdimin e procedurave për pajisjen e shoqërisë së mësipërme me lejen përkatëse në funksion të veprimtarisë minerare në zonën e licencuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë.

Agjencia Rajonale e Mjedisit Fier/Vlorë/Gjirokastrë : Pas shqyrtimit të dosjes së VNM se Thelluar Njoftim të paraqitur nga zhvilluesi “ Allkurti” sh.p.k për veprimtarinë “Shfrytëzim i mineralit të gurit gëlqeror”, me vendndodhje në objektin “Mali i Pashkasheshit”, bashkia Tirane, ARM Tirane, Durrës, Diber sugjeron që subjekti të marrë masat që zhvillimi i projektit të kryhet në harmoni me mjedisin dhe me ndikim sa më minimal në të. Sugjerojmë zbatimin e masave të listuara më poshtë:

- Kamionat transportues të gurit gëlqeror të jenë të pajisura me bordura mbrojtëse dhe me mushama për të shmangur rënien aksidentale të gurit dhe përhapjen e pluhurave. Të pastrohen gomat e makinave kur të dalin nga territori.
- Të zbatohen standardet dhe praktikatat më të mira gjatë përdorimit të lendeve plasuese. Punëtorët të pajisen me kufje për mbrojtjen nga zhurma.
- Të përdoren sprucator për të shmangur përhapjen e grimcave të pluhurave si pasoje e shpërthimeve gjatë shfrytëzimit të gurit gëlqeror.
- Ujerat e gjeneruara gjatë fazës së ndërtimit të trajtohen sipas Ligjit Nr.29/2024, “Për burimet ujore”.
- Të parashikohen masat për parandalimin dhe shuarjen e zjarreve në rast aksidentesh.
- Të zbatohet orari sipas legjislacionit në fuqi për lëvizjen e automjeteve, për të shmangur vibrimet dhe zhurmën në zonat e banuara.
- Të respektohen standardet zyrtare për zhurmën dhe dridhjet, siç parashikohet në Ligjin 9774/2007; “Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmave në mjedis”; dhe të monitorohen zhurmën dhe dridhjet nga aktivitetet e projektit, siç parashikohet nga Urdhëri i MM 1037/1, datë 12.04.2011 “Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis”.
- Në të gjitha rastet që do të ketë ndërhyrje në mjedis do të duhet të ruhet vegjetacioni si edhe bimësia karakteristike zonale duke mos dëmtuar në asnjë rast peizazhin natyror të zonës së marrë në studim.
- Në rastet se gjatë venies në zbatim të projektit dhe funksionimit të tij do të verëhet prania e flores dhe e faunës të cilat janë specie të rrezikuara ose endemike të tregohet kujdes i veçantë për të mos dëmtuar ato.
- I gjithë territori i shfrytëzimit të rrethohet me rrjete për të parandaluar hyrjen e kafsheve të zonës.
- Të sigurohen pajisje personale mbrojtëse për punëtorët për të minimizuar rreziqet e mundshme që kanosen

Bashkia Tirane shprehet:

□ Ligjit nr. 7850, datë 29.07.1994 “Kodi civil i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar), në lidhje me statusin juridik;

□ Ligjit nr. 10431 datë 09.06.2011, për “Mbrojtjen e Mjedisit” (i ndryshuar), në kushtet e ndërtimit të një projekti “Shfrytëzimi i mineralit të gurit gëlqeror”, rekomandojmë zbatimin e masave të mëposhtme për të ruajtur integritetin dhe sigurinë komunitare e mjedisore:

- Të vendoset sinjalistikë e dukshme dhe masa sigurie përgjatë perimetrit të zonës së aktivitetit, me qëllim paralajmërimin e banorëve dhe përdoruesve të rrugës pranë gurores gjatë zhvillimit të punimeve;

- Të informohet paraprakisht Njësia Administrative përkatëse dhe komuniteti në afërsi të zonës së aktivitetit, lidhur me natyrën e punimeve, kohëzgjatjen e tyre, si dhe ndikimet e mundshme në qarkullimin rrugor dhe zhvillimin normal të aktiviteteve në zonë;

- Të mirëmbahet zona e punimeve dhe rrugët e aksesit, në mënyrë që të shmanget përhapja e materialeve nga shfrytëzimi i aktivitetit, pluhurit apo mbetjeve të tjera në rrugët publike dhe në zonat përreth;

- Të merren masa për stabilizimin e sipërfaqeve të ekspozuara, përmes mbjelljes kompensuese me bimësi autoktone ose masave të tjera rehabilituese për reduktimin e erozionit;

- Të vendosen barriera ose masa mbrojtëse kundër erozionit në zonat ku krijohen sipërfaqe të zhveshura gjatë aktivitetit të shfrytëzimit.

□ Ligjit nr. 29/2024, për “Për burimet ujore” (i ndryshuar), sipas të dhënave hartografike në ASIG në shtresën Hidrografia rezulton se mbi zonën ku parashikohet të zhvillohet aktiviteti ndodhet trup ujqor sipërfaqësor (përrua). Në këto kushte, gjatë projektimit dhe zbatimit të punimeve rekomandohet që të merren masa mbrojtëse me qëllim që ky element hidrografik të mos preket apo të ndikohet negativisht nga aktiviteti, si dhe të respektohen distancat mbrojtëse nga brigjet e rrjedhës ujore, në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi konkretisht:

- Të mos dëmtohen brigjet dhe shtrati i rrjedhës ujore, si dhe të shmanget çdo ndërhyrje që mund të ndryshojë rrjedhjen natyrore të saj;

- Të sigurohet marrja e masave të menjëhershme në rast aksidenti apo incidenti, me qëllim minimizimin ose parandalimin e çdo ndikimi të mundshëm në mjedisin ujor;

- Të respektohet distanca minimale ligjore nga trupi ujor, duke ruajtur një brez mbrojtës natyror që kontribuon në filtrimin e ujërave sipërfaqësore dhe reduktimin e erozionit;

- Të merren masa për menaxhimin e ujërave sipërfaqësore dhe ujërave të shiut, në mënyrë që të parandalohet transportimi i sedimenteve, materialeve inerte apo ndotësve drejt rrjedhës ujore.

- Të sigurohet që aktiviteti i shfrytëzimit dhe lëvizja e mjeteve të mos ndryshojë regjimin natyror të rrjedhjes apo morfologjinë e shtratit të përroit;

- Të merret mendimi i autoritetit kompetent për burimet ujore, në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi, për çdo ndërhyrje apo aktivitet që zhvillohet në afërsi të trupave ujore ose që mund të ndikojë në regjimin e tyre hidrologjik.

□ Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 177, datë 31.3.2005 "Për normat e lejuara të shkarkimeve të lengëta dhe kriteret e zonimit të mjediseve ujore pritëse".

- Të ndalohet shkarkimi i ujërave të ndotura nga larja e mjeteve të ndërtimit në drejtim të burimit ujor;

- Të merren masa për stabilizimin e brigjeve dhe kontrollin e erozionit, për të parandaluar shpërndarjen e materialeve inerte në trupin ujor;

- Të parashikohen masa për menaxhimin e ujërave sipërfaqësore dhe ujërave të shiut, në mënyrë që të shmanget transportimi i sedimenteve drejt rrjedhës ujore;
- Të vendosen barriera fizike mbrojtëse për të parandaluar shpërndarjen e materialeve ndërtimore drejt burimit ujor;
- Të shmanget depozitimi i materialeve nga shfrytëzimi, apo mbetjeve në afërsi të rrjedhës ujore ose në zona me pjerrësi që mund të shkaktojnë erozion dhe transport materialesh drejt përroit;
- Ligjit nr. 57/ 2025, datë 16.10.2025, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”;
- Të kontraktohen subjekte të licencuara për transportin dhe trajtimin e mbetjeve që gjenerohen nga aktiviteti, në përputhje me legjislacionin në fuqi;
- Të ndalohet depozitimi i pakontrolluar i mbetjeve në territor, përfshirë hedhjen në toka të hapura, kanale kulluese, rrjedha ujore ose zona të gjelbra;
- Të kryhet ndarja e mbetjeve në burim, sipas llojit dhe rrezikshmërisë (inerte, jo të rrezikshme, të rrezikshme), dhe të shmanget përzierja e tyre;
- Të parashikohet një sistem për grumbullimin dhe largimin periodik të mbetjeve, si dhe administrimin e materialeve të tepërta që krijohen gjatë procesit të shfrytëzimit;
- Të merren masa për pastrimin e mjeteve dhe rrotave të automjeteve që lëvizin brenda dhe jashtë zonës së aktivitetit, me qëllim shmangien e transportimit të materialeve dhe ndotjes në rrugët publike;
- Të sigurohet menaxhimi i duhur i vajrave, lubrifikantëve dhe mbetjeve të rrezikshme që mund të gjenerohen nga mirëmbajtja e mjeteve dhe pajisjeve, duke i depozituar në kontejnerë të përshtatshëm dhe duke i dorëzuar tek subjekte të licencuara.
- Gjatë fazës ndërtimore mbetjet inerte të gjeneruara të trajtohen sipas kërkesave të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 575, datë 24.06.2015 “Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte” (i ndryshuar);
- Mbetjet të dorëzohen vetëm në landfille ose venddepozitime të përkohshme të miratuara, të përcaktuara nga njësia e qeverisjes vendore ose nga autoritetet kompetente;
- Të sigurohet ruajtja e përkohshme e mbetjeve vetëm në zona të autorizuar, duke respektuar distancat dhe sasitë e lejuara dhe duke shmangur çdo ndikim negativ në mjedis dhe shëndetin publik;
- Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 229, datë 23.04.2014 “Për rregullat për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe dokumentin përkatës” (i ndryshuar);
- Subjekti që do të transportojë ose do të transferojë mbetjet të jetë i pajisur me licencë III.2.B, si detyrim i nenit 57, të ligjit nr. 10463, datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” (i ndryshuar);
- Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 258, datë 27.04.2023 “Për përcaktimin e kushteve, Kriterëve, Procedurave të Shqyrtimit dhe Vendimmarrjes, Formatit dhe Afateve për Dhënien e Autorizimit për përdorim Civil të Lëndëve Plasëse”;
- Në bazë të Urdhërit nr. 67, datë 11.03.2018 “Për miratimin e Planit të Veprimtë për Veprimtaritë Minerare me Karriere (Gurore)”, rekomandohet të zbatohet:
- Rehabilitim progresiv i zonave të përfunduara, pas përfundimit të punimeve, duke përfshirë stabilizimin e terrenit;
- Të realizohet rikthimi i zonës në gjendje të përafërt me atë të mëparshme pas përfundimit të aktivitetit, duke kultivuar bimësi autoktone dhe marjen e masave për mbrojtjen e ekosistemit;
- Të realizohet modelimi i skarpave me pjerrësi të qëndrueshme për të parandaluar rrëshqitje të tokës dhe erozion;

- Zonat e përfunduara të sistemohen dhe stabilizohen pas përfundimit të shfrytëzimit të zonës;
- Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 418, datë 27.05.2020 “Për miratimin e Politikave Strategjike dhe Planit Kombëtar për Menaxhimin e Mbetjeve 2020–2035”.
- Për të gjitha mbetjet nga ambalazhet të zbatohet Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 177, datë 06.03.2012, “Për ambalazhet dhe mbetjet e tyre” (i ndryshuar);
- Ligjin nr. 10304, datë 15.07.2010 “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë”, (i ndryshuar);
- Ligjin nr. 57/2020, datë 30.4.2020 “Për pyjet”;
- Ligjin nr. 9587, datë 20.7.2006 “Për Mbrojtjen e Biodiversitetit”;
- Ligjin nr. 81/ 2017 “Për zonat e mbrojtura”, (i ndryshuar);
- Mbetjet që do të krijohen, të specifikohen sipas kodeve të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 402, datë 30.06.2021 “Për miratimin e katalogut të mbetjeve”, (i ndryshuar);
- Ligjin 162/2014 "Për mbrojtjen e cilësisë së ajrit në mjedis" (i ndryshuar);
- Të merren masa për minimizimin e shkarkimeve të lëndës së ngurtë pezull (PM10 dhe PM2,5) gjatë zhvillimit të aktivitetit, përmes lagies periodike të sipërfaqeve të hapura, mbulimit të materialeve të imta dhe pastrimit të rrugëve të aksesit;
- Të përdoren vetëm mjete dhe makineri pune të certifikuar teknikisht, në gjendje të mirë funksionale, për të kufizuar shkarkimet e ndotësve në ajër nga burimet e lëvizshme;
- Të kufizohet përhapja e pluhurit gjatë operimit të aktivitetit, përmes menaxhimit të duhur të zonave të punës dhe materialeve të shfrytëzimit;
- Të sigurohet menaxhimi i qarkullimit të mjeteve brenda zonës së aktivitetit, duke shmangur lëvizjet e panevojshme dhe grumbullimin e automjeteve që mund të rrisin emetimet në ajër;
- Të sigurohet që shkarkimet në ajër nga burimet e palëvizshme, nëse parashikohen (gjeneratorë, impiante ndihmëse), të jenë brenda vlerave kufi të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi;
- Të mbulohen mjetet transportuese gjatë transportit të materialit, me qëllim shmangien e përhapjes së pluhurit në rrugët përreth;
- Të respektohen normat e lejuara të shkarkimeve në ajër të ndotësve të gaztë dhe lëndës së ngurtë pezull, në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 435, datë 12.9.2002 “Për miratimin e normave të shkarkimeve në ajër në Republikën e Shqipërisë” (i ndryshuar);
- Aktiviteti të projektohet dhe të operojë në mënyrë të tillë që shkarkimet në ajër të mos tejkalojnë vlerat kufi të përcaktuara për të gjithë ndotësit përkatës, gjatë fazës së ndërtimit dhe të funksionimit;
- Të merren masa për kontrollin dhe reduktimin e pluhurit, përmes lagies së sipërfaqeve të ekspozuara, rrugëve të brendshme dhe zonave të punës;
- Materialet dhe sipërfaqet që gjenerojnë pluhur të menaxhohen në mënyrë të tillë që të minimizohet përhapja e tij në mjedisin përreth;
- Gjatë fazës së operimit të zbatohen masa specifike për kufizimin e emetimeve të pluhurit dhe gazrave, si: lagia e sipërfaqeve, mbulimi i materialeve, kufizimi i shpejtësisë së mjeteve dhe mirëmbajtja teknike e makinerive;
- Në rast të evidentimit të tejkalimeve të normave të shkarkimeve, të merren masa korrigjuese të menjëhershme dhe të raportohet pranë autoriteteve kompetente, në përputhje me legjislacionin mjedisor në fuqi;
- Të përdoren makineri sipas standardeve për të ulur emetimet nga djegia e karburanteve;
- Ligjit nr. 9774, datë 12.07.2007, “Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis (i

ndryshuar) si dhe Udhëzimit të Përbashkët nr. 2, datë 15.11.2023 “Për nivelin kufi të zhurmës për një mjedis të dhënë dhe për fushën e veprimtarive Ekonomike-Shoqërore”, rekomandohet të zbatohet;

- Përdorimi i pajisjeve ndërtimore me nivel të ulët të emetimeve akustike (të certifikuara);
- Të kufizohen punimet me mjete të rënda në fashat orare të përcaktuara, sipas nenit 10 të ligjit të sipërcituar;
- Të vendosen barrierat të përkohshme për zbutjen e zhurmës, sidomos pranë qendrave të banuara;
- Në rast se gjatë aktivitetit parashikohet përdorimi i shpërthimeve për nxjerrjen e materialit, këto të realizohen në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe duke marrë masa për minimizimin e ndikimit të zhurmës dhe vibrimeve në zonat përreth;
- Të vendosen masa reduktuese të zhurmës si izolimi i pajisjeve të zhurmshme dhe mirëmbajtje periodike e makinerive;

☐ Ligji nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” (i ndryshuar) dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit” (i ndryshuar);

☐ Referuar të dhënave hartografike, konstatohet se në distancë shumë të afërt të zonës së propozuar për zhvillimin e aktivitetit ndodhen monumente natyre, të cilat përfaqësojnë elemente me vlera të veçanta të peisazheve natyrore dhe mjedisore. Në këtë kuadër, sugjerohet që gjatë zhvillimit të aktivitetit të merren në konsideratë afërsia dhe ndjeshmëria mjedisore e këtyre monumenteve, duke parashikuar dhe zbatuar masa të përshtatshme mbrojtëse për të shmangur ose minimizuar çdo ndikim të mundshëm në integritetin dhe vlerat e tyre natyrore, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e zonave dhe monumenteve të natyrës.

2. Informacion për procesin e realizuar të konsultimit me publikun:

Konsultimi me publikun: I mbajtur sot më datë : 03.08.2026, ora 12.00, bazuar në Autorizimin me Nr. 760 Prot., nga specialistet e Sektorit të Lejeve Mjedisore dhe VNM, me vendndodhje Objekti “Mali I Pashkasheshit”, Bashkia Tiranë, Qarku Tiranë, u zhvillua konsulta me publikun e organizuar nga subjekti Allkurti shpk për projektin “Shfrytëzim dhe përpunim i mineralit gur gëlqeror”. Në këtë dëgjuesë, ishin të pranishëm:

- ☐ Përfaqësues nga AKM/ARM
- ☐ Përfaqësues nga NJQV
- ☐ Përfaqësues nga OJF, OJQ
- ☐ Përfaqësues nga shoqëria civile
- ☐ Përfaqësues të biznesit përreth
- ☐ Përfaqësues nga media vizive dhe të shkruara lokale
- ☐ Banorë të zonës përreth

Pas prezantimit të projektit, të pranishmit nuk shprehën ankesa apo sugjerime për vijimin e aktivitetit. Ata firmosën në formularin e tipit II. Konsulta u zhvillua rreth 60 minuta,

3. Arsyet dhe konsideratat kryesore, ku është mbështetur mendimi;

Zhvillimi i aktivitetit është në përputhje me:

- Në mendimin e anëtarëve të Komisionit 93, datë 14.08.2026, i mbledhur në zbatim të Urdhërin nr.15, datë 20.01.2026, për “Krijimin e komisionit teknik për shqyrtimin e kërkesave që i nënshtrohen procedurës paraprake dhe të thelluar të vlerësimit të ndikimit në mjedis”.
- Shkresen nr. 7413/3 Prot, date 24.12.2025 nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë për me lende Njofum për fillim procedure për zgjerimin e lejes Nr.580/3, datë 13.11.2000.
- Shkresën nr.6349/1 prot, datë 30.04.2026, nga Agjencia Kombetare e Burimeve Natyrore;
- Njoftimin për fillim procedure në komisionin Nr.50, datë 12.05.2026.

4. Përshkrimin, sipas rastit, të masave kryesore që duhen marrë për të shmangur, reduktuar e nëse është e mundur, për të korrigjuar efektet negative të rëndësishme:

- 4.1 Ky objekt të ndërtohet në përputhje të plotë me Planin e Përgjithshëm Vendor dhe Planin e Detajuar Vendor, të miratuar nga organet kompetente (KKT / Bashkia / Njësi Administrative) dhe akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.
- 4.2 Ky vendim nuk është leje zhvillimi përfundimtare për zbatimin e këtij projekti, por është një dokument i cili lëshohet me kusht që në rast se do të zhvillohet ky aktivitet, duhet të zbatohet kushtet e vendosura si detyrim që vjen nga Ligji Nr. 10431, datë 9.6.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit”, si dhe Ligji nr. 10 440, datë 07.07.2011 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, të ndryshuar, KREU I, Neni 1, Pika a); KREU II, Neni 7, Pika 1; KREU V, Neni 20, Pika 1.
- 4.3 Në rast se gjatë punimeve shfaqen elemente të tillë si: objekte kulturi, gjurmë arkeologjike, burime ujore etj, subjekti të ndërpresë punimet dhe të lajmërojë urgjentisht organet kompetente.
- 4.4 Deklarata mjedisore është e vlefshme pas heqjes së sipërfaqes së shfrytëzimit nga fondi pyjor. Sipërfaqja e shfrytëzimit të ndahet në sipërfaqe më të vogla, dhe heqja nga fondi pyjor të bëhet me faza sipas akteve nënligjore në fuqi për shfrytëzimin minerar. Për sipërfaqet që janë të zhveshura nga bimësia (sepse sipërfaqja e kërkuar ka ripërtëritje të mirë) duhet marrë me parë miratimi i AKBN-së dhe ndërhyrja të bëhet sipas një grafiku ndërhyrjeje në to, kjo duke patur parasysh parashikimet ligjore të ligjit 57/2020, datë 30.4.2020 “Për pyjet”. si dhe për arsye të rehabilitimit pjesor dhe zbutjen e ndikimit negativ që kanë karrierat e shfrytëzimit minerar në mjedis.
- 4.5 Në bazë të Ligjit Nr. 81/2017, “Për Zonat e Mbrojtura”, nga zbatuesit e projektit të merren masa që mos të dëmtohen zona me status të vecantë.
Gjatë fazës së instalimit: Të vendoset sinjalistika paralajmëruese përgjatë gjithë segmentit të punimeve me qëllim shmangien e aksidenteve njerëzore.
- 4.6 Të instalohet sistemi i eliminimit dhe kapjes së pluhurave, nëpërmjet sprucimit me ujë. (Ky sistem, të detajohet qartë me skica, planimetri etj në aplikimin për Leje Mjedisore)
- 4.7 Të kontrollohen kushtet teknike të mjeteve të punës në mënyrë periodike për të evituar, parandaluar rrjedhjet e lubrifikantëve e të hidrokarbureve në mjedis, emetimin e gazeve të shkaktuara nga avari teknike të mjeteve të subjektit.
- 4.8 Të respektohet distanca nga rruga, gjatë fazës së instalimit dhe kryerjes së punimeve, sipas legjislacionit në fuqi.

- 4.9 Përdorimi i pajisjeve, automjetet, që emetojnë nivele zhurmash brenda normave të lejuara të emetimit 60 – 100 db.
- 4.10 Subjekti të realizojë në mënyrë të menjëhershme çdo ndërhyrje teknike për të riparuar çdo fenomen negativ në mjedis si pasojë e veprimtarisë së tij.
- 4.11 Të sistemohen brenda sipërfaqes së shfrytëzimit të gjitha sterilet e gjeneruara nga shfrytëzimi i karrierës.
- 4.12 Ky Vendim është i vlefshëm pasi subjekti të marrë miratim nga institucionet përkatëse për këtë lloj aktiviteti, bazuar në ligjin Nr. 111/2012 “Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore”, i ndryshuar, si dhe Vendimin nr. 550, datë 15.7.2020 të Këshillit të Ministrave subjekti duhet si me poshte:
- Gjatë punimeve të mos ketë dëmtime të trupave ujqor në të gjithë gjatësinë e tij, nëse ka;
 - Gjatë fazës së punimeve për ndërtimin e rrugës, të mos depozitohen dhera apo materiale nga germimet, apo cdo lloj materiali tjetër ndërtimi në shtratin e trupit ujqor nëse ka,
 - Nëse ka, të mos bllokohet në asnjë rast rrjedhja e ujit ,
 - Gjatë punimeve të mbahet në kontroll, duke prekur sa më pak të mundet seksionin e gjallë të rrjedhës;
 - Të ndalohet shkarkimi i ujërave të ndotura nga larja e mjeteve të ndërtimit në drejtim të burimit ujqor;
- 4.13 Në raste aksidentesh ose defektesh teknologjike që shkaktojnë ndotje të mjedisit, subjekti menjëherë duhet të jap informacion në ARM-në e qarkut përkatës dhe AKM, të cilat bëjnë të mundur njoftimin e popullatës që preket nga ky aksident.
- 4.14 Subjekti të hartojë dhe zbatojë një plan masash lidhur me masat e parandalimit dhe shuarjen e zjarreve në rast aksidentesh nga plasjet për nxjerrjen e materialit.
- 4.15 Të mbillen pemë në të gjithë perimetrin e zonës për të minimizuar ndikimet në mjedis dhe përmirësuar pejsazhin.
- 4.16 Subjekti të kujdeset për menaxhimin e mbetjeve të krijuara gjatë fazës së instalimit, sidomos ato të ambalazhimit, duke i transportuar në mënyrë të rregullt në vend grumbullimit e caktura nga njësia vendore. Zotëruesit e mbetjeve inerte duhet të zbatojnë detyrimet që janë të përcaktuara në VKM nr.575, datë 24.06.2015 “Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte”.
- 4.17 Përgjatë gjithë rrugës së brendshme të karrierës (përfshi transhetë), të hapet një kanal ujëmbledhës i orientuar drejt një grope dekantimi, për mbledhjen dhe disiplinimin e ujërave gjatë kohës së shfrytëzimit.
- 4.18 Të bëhet pastrimi i mjeteve të punës para daljes nga kantieri i ndërtimit për të mos shkaktuar ndotje në mjedis.
- 4.19 Të merren masa për mbrojtjen e biodiversitetit të zonës.
- 4.20 Të kihet kujdes treguesit kadastralë të sipërfaqes pyjore/kullosore që do të përdoret për aktivitetin, të jenë vetëm brënda sipërfaqes së miratuar.
- 4.21 Personi përgjegjes teknik për zhvillimin e aktivitetit duhet të jetë i informuar për bazën ligjore të pyjeve në fuqi dhe për zbatimin e tyre.
- 4.22 Mbetjet që gjenerohen nga procesi i punimeve të trajtohen në përputhje me legjislacionin në fuqi, për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve.
- 4.23 Të bëhet kontrolli i kushteve teknike në mënyre periodike të mjeteve të punës, për të evituar, parandaluar rrjedhjet e lubrifikanteve dhe hidrokarbureve në mjedis, emetimin e ndotësve në gaz të shkaktuara nga avari teknike të mjeteve.

- 4.24 Të merren masa të sigurimit teknik që punimet të mos kryhen në oraret e papërshtatme dhe mbi normat e lejuara të zhurmave, si dhe të zbatohet Udhëzimi nr.8, datë 27.11.2007 “Për nivelet kufi të zhurmave në mjedise të caktuara”, i ndryshuar.
- 4.25 Të përdoren automjete të mbuluara (të mbyllura ose të mbuluara me mbulesë të posaçme) për transportin e materialeve të thata.
- 4.26 Pastrimi i bimësisë të jetë i kufizuar vetëm brenda kufijve ku do të zhvillohet projekti.
- 4.27 Pas përfundimit të fazës së punimeve, sugjerojmë rehabilitimin e plotë të sipërfaqeve të lira dhe krijimin e sipërfaqeve të gjelbërta, përreth objektit.
- 4.28 Subjekti të respektojë kushtet lidhur me mbrojtjen e biodiversitetit, menaxhimin e pyjeve, emetimet në ajër, shkarkimet e ujërave të ndotura, menaxhimin e mbetjeve etj.
- 4.29 Subjekti të respektojë dhe të mbajë parasysh kërkesat dhe kriteret e Ligjit Nr.81/2017 “Për Zonat e Mbrojtura”.
- 4.30 Subjekti të marrë masa për rehabilitim e sipërfaqes së shfrytëzuar.
- 4.31 Kompania duhet të respektojë gjithashtu kushtet e vendosura në raportin e VNM-së të aplikuar si dhe Ligjin Nr. 10 431, datë 9.6.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit”.
- 4.32 Në përfundim të punimeve, të rehabilitohet zona e shfrytëzuar.
- 4.33 Duke qenë se gjatë fazës së funksionimit, ky aktivitet do të ketë efekte në mjedis, në bazë të Ligjit Ligi nr. 52/2020, datë 30.4.2020 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 10 448, datë 14.7.2011, “Për lejet e mjedisit”, të ndryshuar.

5. Monitorimi dhe Raportimi

Në bazë të Ligjit Nr. 128/2020 Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr. 10440, datë: 07.07.2011, “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, të ndryshuar, Neni 25/1 “Monitorimi dhe vlefshmëria”, zhvilluesi ka detyrimet si më poshtë:

- Zhurma dhe Vibracionet

- Të zbatohen nivelet kufi të zhurmës, referuar Udhëzimit Nr. 8, datë 27.11.2007 “Për nivelet kufi të zhurmave në mjedise të caktuara” dhe Ligjit Nr.9774 datë 12.07.2007 “Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis”
- Të merren masa për mbrojtjen e punonjësve nga zhurmat.
- Të merren masat për kufizimin e orareve të punës në kantier.
- Operatori duhet të parandalojë gjenerimin e zhurmës impulsive në zonat e ndjeshme ndaj zhurmës, gjatë operimit të instalimeve.
- Vibrimet në vende të ndjeshme nuk duhet të kalojnë 10 mm/s (PPV) në çdo kohë.
- Të bëhet monitorimi i zhurmave për mjediset: automjete/kamiona në hyrje të kantierit, kantier ndërtimi dhe mjedisi urban më i afert me kantierin çdo 6 muaj.

Mjedisi	Vlera kufi e zhurmës dB(A) Leq, T Ditë	Vlera kufi e zhurmës dB(A) Leq, T Mbrëmje	Raportimi në AKM	Periodiciteti
Automjete/kamiona në hyrje të kantierit	55	45	16.02.2027	Çdo 6 muaj
Kantier ndërtimi	55	45	16.02.2027	Çdo 6 muaj

Mjedisi urban me i afërt me kantierin	55	45	16.02.2027	Çdo 6 muaj
---------------------------------------	----	----	------------	------------

Tabela e niveleve kufi:

- **Shkarkimet në Ajër**
- Të zbatohen nivelet kufi të shkarkimeve në ajër, referuar Ligjit Nr. 162/2014 “Për Mbrojtjen e Cilësisë së Ajrit në Mjedis” dhe VKM Nr. 248, datë: 24.03.2003 “Për Miratimin e Normave të Përkohshme të Shkarkimeve në Ajër dhe Zbatimin e tyre”.
- Shkarkimet në ajër të jene brenda normave të lejuara, duke marre masa për reduktimin e tyre.
- Kantieri në të cilin emetohen lëndë grimcore në ajër, duhet të pajiset sipas mundësive teknike dhe mbi bazën e natyrës së procesit, me rrjeta uji / sisteme spërkatje / sisteme heqje pluhurash.
- Të bëhet monitorimi i nivelit të pluhurave në ajër, për mjediset: kantier ndërtimi dhe mjedisi urban më i afërt me kantierin çdo 6 muaj.

Tabela e niveleve kufi

Ndotësi	Përqëndrimi	Raportimi në AKM	Periodiciteti
Lënda grimcore (PM _{2.5})	20-25 µg/m ³	16.02.2027	Çdo 6 muaj
PM ₁₀	50 µg/m ³ , 40 µg/m ³	16.02.2027	Çdo 6 muaj

- **Cilësia e ujrave**

Parametrat që duhet të monitorohen

Ndotësi	Përqëndrimi	Raportimi në AKM	Periodiciteti
Lëndët në pezulli	50 mg/l	16.02.2027	Çdo 6 muaj

- **Subjekti duhet të sjellë pranë AKM-së si më poshtë:**
- Informacion në momentin e fillimit të punimeve.
- Informacion për menaxhimin e mbetjeve inerte. Zotëruesit e mbetjeve inerte duhet të zbatojnë detyrimet që janë të përcaktuara në VKM nr.575, datë 24.06.2015 “Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte”, dhe transporti të kryhet nga subjekte të licensuara, të pajisura me Kod Unik.
- Raportimin periodik për parametrat që do të monitorohen sipas datës së raportimit/çdo 6 muaj.
- Informacion në përfundim të punimeve, lidhur me punimet rehabilituese të territorit përreth, shoqëruar edhe me foto.
- **Afati i Vlefshmërisë**
- Vendimi për Deklaratë Mjedisore për projektin e propozuar është e vlefshme për aq kohë sa është i vlefshëm edhe dokumenti i miratimit të zhvillimit për projektin.
- Nëse projekti, që i është nënshtruar procesit të VNM-së, nuk fillon zbatimin në terren brenda 2 vjetëve nga data e miratimit të deklaratës mjedisore apo të vendimit për VNM-në paraprake, atëherë këto dokumente konsiderohen të pavlefshme dhe procesi i VNM-së fillon nga e para.

Në bazë të udhëzimit të MM dhe MF nr. 7938, datë 17.7.2014 “Për përcaktimin e tarifave dhe vlerave përkatëse për shërbimet që kryen Ministria e Mjedisit për procesin e VNM-së”, ky subjekt ka kryer pagesën 50.000 lekë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

MARJETA PËRLALA

MINISTRI

SOFJAN JAUPAJ

Aneksi 1. Harta me Koordinatat sipas AKBN

